



Mësimi 4:

Epoka Post-së Vërtetës dhe Çrregullimi i Informacionit

Koha për përgatitje: **30 minuta**

Kohëzgjatja e modulit: **1 x 60 minuta**

Abstrakt

Ky modul shqyrton sfidat që sjell çrregullimi i informacionit në epokën digjitale. Ai analizon mënyrën se si përhapet informacioni i rremë dhe mashtrues dhe eksploron kategori të ndryshme të këtij fenomeni. Gjithashtu trajtohet koncepti i epokës post-së vërtetës. Pjesëmarrësit do të hetojnë shembuj nga jeta reale, do të njohin mjete të ndryshme për verifikimin e këtij informacioni dhe do të diskutojnë pasojat etike dhe shoqërore të keqinformimit. Qëllimi i këtij moduli është të forcojë aftësitë e mendimit kritik dhe edukimit mediatik, për të ndihmuar pjesëmarrësit të orientohen në një botë të mbushur me çrregullim informacioni.

Burime edukative online

- Artikujt e Institutit [Poynter](#) mbi verifikimin e fakteve në internet
- Mjetet e Universitetit Shtetëror të Arizonës për të identifikuar imazhe dhe [video të rreme](#)
- Zbulimi i lajmeve të rreme nga [FactCheck.org](#) në Facebook dhe platforma të tjera
- “Orientimi në një botë post-së vërtetës”, fjalim TEDx nga Charles Sykes
- Mjete online për verifikim: Snopes, FactCheck.org, Politifact, guides.vote

Fjalë kyçe

*Keqinformim,
Dezinformim,
Keqdashje me informacion
(Malinformim),
Epoka post-së vërtetës,
Edukimi mediatik,
Mendim kritik*

Qëllimi i modulit

Qëllimi i këtij moduli është të ndihmojë pjesëmarrësit të zhvillojnë një kuptim të fortë mbi mënyrën se si funksionon çrregullimi i informacionit dhe si ndikon ai në perceptimin publik. Gjatë këtij sesi, pjesëmarrësit do të mësojnë si përhapet keqinformimi, si të identifikojnë format e ndryshme të përmbajtjes mashtruese dhe çfarë strategjish mund të përdoren për të verifikuar saktësinë e informacionit. Nëpërmjet një qasjeje të bazuar në mendimin kritik, ky modul synon t'i përgatisë pjesëmarrësit të angazhohen me median në mënyrë të përgjegjshme dhe të menduar.

Rezultati i modulit

Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë keqinformimin, dezinformimin dhe malinformimin (Informacion i keqpërdorur).
- Identifikojnë teknikat e përdorura në përmbajtje mashtruese, si media të manipuluar apo të fabrikuara.
- Njohin shembuj konkretë të keqinformimit dhe analizojnë ndikimin e tyre.
- Përdorin mjete digjitale për të verifikuar informacionin dhe për të kundërshtuar narrativat e rreme.
- Marrin pjesë në diskutime rreth pasojave etike të çrregullimit të informacionit sot.

Procesi i zbatimit të modulit

Min. 1–10: Hyrje

- Angazhoni pjesëmarrësit me një sondazh : “A jeni përfshirë ndonjëherë me informacion online që më vonë rezultoi i pavërtetë? Kjo përfshin ndarjen, besimin apo përhapjen e atij informacioni.”
- Diskutoni përvojat personale me keqinformimin dhe prezantoni konceptet kryesore të mësimi.
- Shfaqni një video të shkurtër dhe nxitëse për të menduar rreth keqinformimit viral (opsionale, në varësi të kohëzgjatjes së diskutimit).

Min. 11–30: Aktivitet Ndërveprues

- Shpjegoni tre kategoritë kryesore të çrregullimit të informacionit: dezinformimi, keqinformimi dhe malinformimi.
- Jepni shembuj nga jeta reale, si keqinformimi gjatë zgjedhjeve, videot e manipuluar (deepfakes) dhe teoritë konspirative.
- Diskutoni se si emocionet dhe paragjykimet kontribuojnë në politikën post-së vërtetës.
- Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla për të analizuar raste studimore të ndryshme të keqinformimit.

Min. 31–50: Zbatim Praktik

- Drejtoni pjesëmarrësit për mënyrën se si të verifikojnë informacionin duke përdorur mjete për verifikimin e fakteve.
- Krahasoni përmbajtje të medias reale dhe të rreme, duke kërkuar për mospërputhje në kontekst dhe manipulim të imazheve.
- Drejtoni një debat mbi dilemat etike: “A duhet që platformat e rrjeteve sociale të rregullojnë më rreptësisht keqinformimin?”

Min. 51–60: Përfundimi

- Rikapitulloni mësimet e nxjerra, përfshirë rëndësinë e edukimit mediatik.
- Organizoni një kuiz në Kahoot për të përforcuar konceptet kryesore të çrregullimit të informacionit.
- Inkurajoni pjesëmarrësit të ushtrojnë teknikat e verifikimit të medias edhe jashtë klasës.

Materiale / Mjete

Projektor, laptop/kompjuter desktop, lidhje interneti; shembuj të përmbajtjes së manipuluar dhe të fabrikuar; qasje në mjete për verifikimin e informacionit (Snopes, TinEye, FactCheck.org); Kahoot ose një kuiz i ngjashëm.